



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1283 prot.

Tiranë, më 13. 09. 2021

**V E N D I M**

**Nr. 167, datë 13. 09. 2021**

Bazuar në pikën 11<sup>1</sup>, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

**K O N S T A T O N:**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat "b", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33 të Ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 76, datë 20.07.2020, të Fondacionit "Së Bashku"<sup>2</sup>, kundër Bashkisë Durrës dhe Operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të aftësisë së kufizuar*.

Bazuar në nenin 33/10 të Ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 26, datë 16.02.2021, me anë të të cilit ka vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas "*M..... Buss sh.p.k.*".

<sup>1</sup> Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

<sup>2</sup> Përfaqësuar nga znj. S. L., në cilësinë e Drejtores Ekzekutive

3. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas “*I.....Trans sh.p.k.*”.
4. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Durrës, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, në mjetet e transportit të shërbimit urban qytetas dhe përshtatjen e stacionëve të autobuzëve për personat me aftësi të kufizuar.
5. Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit “*M..... Buss sh.p.k.*”, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Në referencë të pikës 3, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit urban “*I..... Trans sh.p.k.*”, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
7. Në referencë të pikave 1, 2 dhe 3, Bashkia Durrës dhe Shoqëritë e transportit “*M..... Buss sh.p.k.*” dhe “*I..... Trans sh.p.k.*”, të marrin masa për trajnimin e stafit të shërbimit, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.
8. Marrja e masave si më sipër, duhet të realizohet nga ana e Bashkisë Durrës dhe Shoqërive të transportit “*I..... Trans sh.p.k.*” dhe “*M..... Buss sh.p.k.*”, brenda një afati prej 3 (tre) muajsh, nga dita e komunikimit të këtij vendimi.
9. Komisioneri i rekomandon Bashkinë Durrës që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së transportit publik, si në mjetet e transportit por edhe në stacionet tyre, të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Në pikën 10 të këtij vendimi, është kërkuar që, Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “*I.... Trans sh.p.k.*” dhe “*M..... Buss sh.p.k.*”, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet konkrete të ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Me shkresën nr. 311/2 prot., datë 19.05.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa informacion lidhur me plotësimin e Vendimit Nr. 26, datë 16.02.2021.

Me shkresën<sup>3</sup> Nr. 6136/1 prot., datë 27.05.2021, Bashkia Durrës, ka kthyer përgjigje Komisionerit, duke deklaruar në mes të tjerash se: “*Në zbatim të vendimit, Bashkia Durrës ka zhvilluar disa takime me subjektet e transportit publik, lidhur me problematikën e mungesës së aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuar në mjetet e transportit publik. Më tej këto*

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 311/3 prot., datë 31.05.2021

*subjekte kanë përmirësuar shërbimin e transportit publik ndaj kësaj kategorie udhëtarësh, gjë e cila provohet me faktin se pranë institucionit tonë nuk janë paraqitur më ankesa verbale dhe me shkrim mbi këtë problematikë”.*

Në përgjigje për sa sipërcituar, Bashkia Durrës nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo informacion sa i përket marrjes së masave konkrete lidhur me zbatimin e vendimit të KMD-së.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Bashkia Durrës është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi nuk ka zbatuar Vendimin nr. 26, datë 16.02.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 32/1, germa “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/b, 14 dhe 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Bashkia Durrës, të gjobitet në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.
2. Gjoha të ekzekutohet dhe të derdhet në Buxhetin e Shtetit jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit, me kërkesë të Komisionerit.
3. Pagesa e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit nr. 26, datë 16.02.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**